

Assoc. Prof. Dr. Muhamed Ali*
Dr. Islam Islami**

MEMORIZIMI I KURANIT NË MAQEDONINË E VERIUT MES EDUKIMIT FORMAL DHE JOFORMAL

Ndonëse kombet e rajonit të Ballkanit u njohën me islamin para ardhjes së osmanëve në këto treva, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane ky besim i ri u shndërrua në veçori dalluese të një pjese të shoqërive të këtij rajoni. Një nga objektivat kryesore të osmanëve, të cilët luajtën rol vital në zhvillimet shoqërore të rajonit të Ballkanit, ishte edhe sigurimi i zhvillimit shpirtëror dhe intelektual të myslimanëve të këtij rajoni, përfshirë këtu edhe avancimin e praktikës së mësimi përmendësh të Kuranit (Hifz). Kjo praktikë kultivohej dhe ruhej përmes shkollave të emërtuara si “*Shkolla për Hifz*” dhe “*Dar’ul Qurra*”. Gjatë historisë, në shkollat e lartpërmendura u diplomuan mijëra myslimanë të rinj nga ky rajon, të cilët luajtën rol të rëndësishëm pozitiv në rrethin e tyre.

Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, Maqedonia e Veriut si një nga vendet kryesore që dallohej për mësimin përmendësh të Kuranit në Ballkan, u bë pjesë e Mbretërisë së Jugosllavisë, e cila pas Luftës së Dytë Botërore u shndërrua në Jugosllavi Socialiste. Përkundër faktit se myslimanët e Maqedonisë së Veriut nga fillimi i shekullit XX e deri më tani, u përballën dhe ende përballen me vështirësi dhe sfida të ndryshme sociale, ekonomike, politike, ata dhanë maksimumin e tyre për ruajtjen e vlerave të tyre fetare, përfshirë këtu edhe praktikën e nxënies përmendësh të Kuranit, gjegjësisht “hifzit”.

Kohët e fundit, memorizimi i Kuranit në këtë vend mirëmbahet përmes metodave të ndryshme. Ky synim arrihet ose me anë të funksionimit të shkollave speciale zyrtare (arsimi formal), ose nëpërmes individëve profesionistë (arsimi joformal) dhe fill pas përfundimit të suksesshëm të hifzit, memorizuesit e Kuranit detyrohen t’i nënshtrohen provimit zyrtar të përgatitur nga zyra përkatëse e Bashkësisë Fetare Islame.

* Universiteti i Sharjah, Emiratet e Bashkuara Arabe.

** Medreseja "Isa Beu", Shkup, Maqedoni e Veriut.

Ky punim do të japë një vështrim të përgjithshëm mbi historinë e hifzit në botën islame, do të elaborojë fazat e zhvillimit të institucionit të hifzit gjatë historisë islame, do të shqyrtojë historinë e hifzit në Maqedoninë e Veriut, si dhe do të analizojë praktikën e nxënies së Kuranit përmendësh mes edukimit formal dhe atij joformal.

Vështrim i përgjithshëm mbi historinë e memorizimit (Hifzit)

Fjala “hafidh” (shumës huffadh), është një mbiemër arab që rrjedh nga rrënja “hifdh” dhe në kuptimin etimologjik ka kuptimin e «mbrojtjes, mësimit përmendësh», që nënkuptohet si mbrojtje e Kuranit dhe memorizimi i tërë Kuranit. Fjala “hafidh” është përdorur në disa ajete të Kuranit në kuptimin etimologjik si attribute të Allahut xh.sh, në ajetet 64 të sures Jusuf, 9 të sures Hixhr, dhe 82 të sures El-Enbija.

Nga ana tjetër, i Dërguari Muhamedi a.s. krahasoi hafëzët me «sefere-i kiram» të përmendura në sure Abese (15-16) dhe paralajmëroi që hafëzët do t'i shoqërojnë ata në xhenet (Musnedi i Imam Ahmed bin Hanbelit, vëll. VI, f. 110; Darimi, pjesa «Fadailu'l-Ḳur'an», kreu 11; Tirmidhi, pjesa «Fada'ilu'l-Ḳur'an», kreu 13). Mësuesit nga grupi i As-habu Suffe që u dërguan nga i Dërguari i Allahut fiseve të ndryshme u quajtën «kurra». Në këtë kuptim, ata që ranë shehid në Bir-i maune, u quajtën gjithashtu «kurra» Buhari, pjesa «Vitir», kreu 7; Muslim pjesa «Mesaxhid», hadithi nr. 301). Sipas një transmetimi, halifi Omeri r.a kishte kurra pleq dhe të rinj rreth vetes, me të cilët këshillohej shpeshherë. Gjithashtu duhet theksuar se sipas një transmetimi në mesin e Harixhijve që luftonin kundër Aliut r.a kishte mbi 8000 kurra, por sipas imam Ahmedit shumica e tyre ishin që dinin vetëm të shkruanin dhe të lexonin, e një pjesë tjetër ishin nga hafëzët e Kuranit. (Musnedi i Ahmed bin Hanbelit, vëll. I, f. 86).

Më vonë, ata të cilët e mësonin përmendësh Kuranin dhe njihnin disa nga kiraetet, po edhe duke mos e kuptuar kuptimin e tij, filluan të emërtoheshin “kurra”. Pas periudhës së tabiinëve, shkencat islame u dobësuan dhe njerëzit nuk ishin në gjendje ta mësonin tërë Kuranin, dhe kështu një grup u përpoq të mësojë vetëm karakteristikat gjuhësore të Kuranit, pa u përqendruar në kuptimet e Kuranit. Sipas Ibn Haldun, që nga kjo periudhë, fjala “kurra” u zëvendësua me fjalët «fukahâ» dhe «ulemâ» (Ibn Haldun, 1983, f. 1049). Si sinonim i fjalës “hafidh” është përdorur edhe fjala “hamil”, që do të thotë bartës, kështu që në një hadith të Profetit

a.s, thuhet se respektimi për hamilin e Kuranit (bartësin e Kuranit), i cili nuk e ka harruar pasi e ka memorizuar atë, do të thotë respektim ndaj Allahut në mënyrë indirekte (Ebu Davud, pjesa «Edeb», kreu 20).

Po ashtu duhet theksuar se për hafëzët e Kuranit është përdorur edhe sinonimi Ehl-Kuran dhe Sahib al-Kuran. Në një hadith përmendet se shkalla e sahibul-Kuran në botën tjetër do të jetë e lartë në proporcion me numrin e ajeteve që ai i memorizon (Ibn Maxhe, pjesa «Adab», kreu 52; Ebu Davud, pjesa «Vitr», kreu 20; Tirmidhi, pjesa «Shevabul Qur'an», kreu 18). Nuk duhet harruar se Profeti Muhamedi a.s, inkurajonte mësimin e Kuranit në këtë kontekst, duhet cituar hadithi i tij :

«Më i miri prej jush është ai i cili e mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve»

(Buhari, pjesa «Fedailul-Ķuran», kreu 21; Ebu Davud, pjesa «Vitr», kreu 14,15,19; Tirmidhi, pjesa «Shevabul Qur'an», kreu 15).

Shumica e stimujve profetikë lidhur me mësimin e Kuranit synojnë jo vetëm memorizimin, por të kuptuarin e tij, njohjen e përmbajtjes së tij dhe veprimin në bazë të direktivave të tij.

Ndonëse ka dilemë rreth numrit të saktë të shokëve të Profetit a.s, që kanë memorizuar Kuranin, gjatë analizimit të thënieve profetike vërejmë se ai inkurajon te të tjerët mësimin e Kuranit nga 4 ashab të dalluar si, Abdullah b. Mes'ud, Salim Maula Ebij Hudhejfe, Muadh b. Xhebel dhe Ebij b. Kab'i (Buhârî, pjesa «Fadailul-Ķur'an», kreu 8). Nga muhaxhirët Talha bin Ubejdullah, Saad bin Ebi Vekasi, Ebu Hurejra, ndërsa nga sahabet femra Aisheja r.a, Hefseja, Umu Seleme etj. Duhet theksuar se shokët e Pejgamberit a.s. në kohën e tij apo pas vdekjes së tij kanë dhënë mësimë rreth Kuranit në qendra të ndryshme, si Meka, Medina, Kufa, Basra, Damask dhe Egjipt. Në shekujt e parë të hixhrit, hifzi i Kuranit kryhej kryesisht në xhami. Përveçse në Mesxhid al-Nabavi, memorizimi i Kuranit praktikohet edhe në nëntë xhami tjera në Medine. Po ashtu, mënyra tjetër e memorizimit ishte memorizimi që kryhej edhe nëpër shtëpi private, si shembulli i shtëpisë së Mahreme bin Nevfel, ku nxënësit mësonin Kuranin përmendësh (Huzai, 1981, f. 80). Në periudhat në vijim, disa mësues i përdorën shtëpitë e tyre si shkolla. Për shembull, shtëpia e Ebu Is-hak al-Tabarit ishte një vend takimi për nxënësit e Kuranit dhe hadithit (Ibn al-Xhazari, 1982, f. 6).

Pas vdekjes së Profetit a.s., interesi për memorizimin e Kuranit është rritur gradualisht. Në këtë kontekst duhet përmendur shembulli i guvernatorit të Basrës, Ebu Musa El Eshari, i cili në një letër që ia kishte

dërguar halifit Omar, kishte informuar se sa shumë njerëz në Basra kishin memorizuar Kuranin. Pas kësaj kishte pasur vendimi i halifit për shpërblimin e tyre me pagë. Megjithatë, vitin në vijim kur mori vesh halifi se politika e tij kishte rezultuar me rritjen e numrit të hafëzëve dhe me zvogëlimin e numrit të njerëzve që merreshin me dispozitat e Kuranit urdhëroi ndërprerjen e pagave (Al Kettani, 1993, v. III, f. 95). Duhet theksuar edhe rasti i Zubejdes, e cila ishte gruaja e halifit Haruner Reshid, e cila ka pasur rreth 300 robëresha hafëze në pallatin e halifit (Ibn Hallikan, 1978, v.II, f. 314). Nga ana tjetër, në Andaluzi, disa xhami ishin të rezervuara për memorizimin e Kuranit. Nxënësit myslimanë të Andaluzisë fillonin arsimin e parë me shkrim, matematikë dhe njohuri gjuhësore, pastaj memorizonin një pjesë apo komplet Kuranin në bazë të aftësive të tyre, e më në fund vazhdonin edukimin e tyre përmes mësimëve të fikhut dhe hadithit (Ibnul Arabi, 1974, v. IV, f. 1895).

Në shekujt vijues, procesi i memorizimit të Kuranit përveçse në xhami dhe darulkurra vazhdoi edhe në medrese, darulhuffaz, darulhadith dhe tyrbe (Zehebi, 1995, v. III, f. 1246, 1250; Ibn al-Xhazari, 1982, v. I, f. 569). Sipas informacionit të dhënë nga Evliya Çelebi, lokacioni i darulkurra në Stamboll zakonisht gjendej në kuadër të xhamive, por kishte edhe raste kur këto institucione për memorizimin e Kuranit vepronin si institucione të veçanta. Metoda e memorizimit të Kuranit ishte si në vijim: memorizoheshin nga 5 apo 10 ajete, dhe pa i memorizuar në mënyrën e duhur nuk kalohej në ajetet vijuese. Disa mësues dëgjonin leximin e disa nxënësve në të njëjtën kohë, për shkak të numrit të madh të tyre. Kishte mësues që i dëgjonin nxënësit e tyre edhe kur ecnin në rrugë (Zehebi, 1995, v. III, f. 1247-1248). Në shumë pjesë të botës islame, memorizimi i Kuranit fillonte në moshë të re. Sipas Evliya Çelebiut, në Amasja kishte nëntë darulkurra dhe vetëm në Darulkurran e Sulltan Bejazitit kishte më shumë se 300 hafëzë (Evliya Çelebi, 1938, v. II, f. 188). Gjithashtu, sipas Çelebiut, vetëm në Stamboll kishte rreth 9000 hafëzë, nga të cilët 3000 ishin gra (Evliya Çelebi, 1938, v. I, f. 524).

Duhet cekur se pas themelimit të Republikës së Turqisë e deri në vitin 1950 numri i nxënësve që merreshin me memorizimin e Kuranit ishte i vogël. Në vitet 1923-1933 numri i qendrave për mësimin e Kuranit ishte vetëm 9, ndërsa në vitin 1991 numri i tyre arriti në 5000. Numri i nxënësve që kanë kryer hifzin në qendrat e mësimin të Kuranit dhe kanë arritur të marrin diplomë nga Dijaneti i Turqisë për kryerjen e hifzit deri në vitin 2015 është 120 063, duke mos përfshirë numrin e atyre që nuk janë të regjistruar në regjistrin e këtij institucioni (Bozkurt,

“Hafiz”, v. XV, f. 74-78).

Në Egjipt, procesi i hifzit të Kuranit realizohet nën administrimin e Ministrisë së Evkafit dhe Az-harit, dhe sipas të dhënave të vitit 1995 numri i qendrave që merreshin me mësimin dhe memorizimin e Kuranit ishte afro 5000, dhe kishte mbi 250 000 nxënës. Nga ana tjetër, në Indi, shkollat sufiste dhanë kontribut të madh në memorizimin e Kuranit, me çka numri i hafëzëve ishte rritur shumë në krahasim me vendet e tjera islamike. Në Pakistan, mësimi i Kuranit ka vazhduar në më shumë se 3000 medrese. Sot, në medresetë e Pakistanit, nxënësit përfundojnë memorizimin e Kuranit para se të fillojnë me arsimin e tyre bazë (Bozkurt, “Hafiz”, v. XV, f. 74-78).

Memorizimi i Kuranit në Ballkan pas periudhës osmane

Në Ballkan, që nga periudha osmane, institucioni i hifzit tërhoqi interes të madh dhe mbështetje nga myslimanët e këtyre trojeve, ndaj dhe shumica e xhamive kishin shkolla, të quajtura “medreseja e hafëzëve” ose “dârülkurrâ”. Në këto institucione, mësonin nxënësit nga mosha dhjetë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare, dhe në fund i nënshtroheshin provimit para mësuesve të ashtuquajtur “hafiz-i kavi” ose “hafsalkari”, nga e hëna deri në namazin e xhumasë kur mbahej ceremonia e përfundimit të hifzit me anë të leximit të duasë së hatmes. Hafëzët që dëshironin të përforconin hifzin e tyre, lexonin mukabele nëpër xhamitë e qyteteve gjatë Ramazanit apo tre muajve të bekuar. Pas Luftës së Parë Botërore, dhe veçanërisht që nga periudha e sundimit komunist, ka pasur një ulje të konsiderueshme të procesit të memorizimit të Kuranit në Ballkan, veçanërisht në Shqipëri, Mal të Zi, Kosovë, Sanxhak, Bosnjë dhe Bullgari. Nga ana tjetër, Shkupi dhe rajoni i tij kanë ruajtur traditën e përgatitjes së hafëzëve të rinj, madje edhe në kushtet më të vështira, duke plotësuar nevojën e myslimanëve të rajonit të Ballkanit për hafëzë të rinj (Fazlić, 1981, f. 9-12; Hasandedić, 1977, f. 92-113).

Memorizimi i Kuranit në Maqedoninë e Veriut mes edukimit formal dhe joformal

Pas pavarësimit të Maqedonisë së Veriut vazhdoi tradita e myslimanëve të këtij vendi për memorizimin e Kuranit, qoftë në mënyrë të organizimit

formal apo joformal, kështu që në vitin 1993 me dekret të Reis ul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi u hap institucioni i parë zyrtar për përgatitjen e hafëzëve dhe si drejtor u emërua Hfz. Taip Aliu. Gjatë punës së tij në këtë institucion, Taip Aliu arriti që të nxjerrë në vitin 1994, 5 hafëzë, në 1995-n, 3, dhe në 1997-n, 7 hafëzë. Ndër kushtet për pranimin e kandidatëve në këtë institucion ishin: kryerja e klasës së 6-të në shkollën fillore, leximi i rrjedhshëm i Kuranit Famëllartë, zëri, sjellja etj. Hifzi zgjaste rreth 2 vjet. Duhet theksuar se hafëzët që e kryenin hifzin në këtë institucion kishin përparësi gjatë regjistrimit të tyre në medresenë “Isa Beu”. Pas kryerjes së hifzit të muhaffizi, nxënësit i nënshtroheshin provimit të komisionit të caktuar nga Myftinia, dhe diplomat i lëshonte Bashkësia Fetare Islame (Meshihati) (Mehdiu, 2010, f. 12-18).

Në vitin 2018, Myftinia e Shkupit mori iniciativë për ringjalljen e institucionit të hifzit dhe bëri rihapjen e këtij institucioni që kishte vepruar gjatë viteve '90-të me në krye hafëz. Taip Aliun. Drejtor të këtij institucioni Myftinia caktoi hafëz. Xhemail Nuhiun dhe riemërtoi me emrin “*institucioni i hifzit Hfz. Ismail Alievski*”. Po ashtu, në vitin 2019, Myftinia e Gostivarit mori një iniciativë të ngjashme duke formuar institucionin e hifzit dhe leximit të bukur dhe Eljesa Asanin e emëroi si drejtor të tij.

Nga ana tjetër, duhet cekur edhe aktiviteti i muhaffizit nga Tetova, mulla Mahmut Asllani, i cili që nga viti 1967 dhe deri në ditët e sotme arriti të përgatisë mbi 200 hafëzë të Kuranit. Sa për kuriozitet, duhet përmendur edhe shembulli i fshatit Studenican, nga rrethina e Shkupit, ku kishte lindur edhe dijetari i madh Ataullah efendi Kurtishi, sepse pikërisht në këtë fshat shumë familje kanë më së paku një apo disa anëtarë hafëzë, fakt ky që tregon shumë për traditën e tyre në fushën e memorizimit të Kuranit (Mehdiu, 2010, f. 20).

Vlen të theksohet se edhe në medresenë “Isa Beu”, në Shkup, gjatë mësimin në arsimin e mesëm, me iniciativën e profesorëve të kiraetit, hafëz. Shafi Osmani dhe hafëz. Sheval Azizi bëhet nxjerrja e hafëzëve të rinj, ku krahas mësimin të detyrueshëm, arrijnë edhe mësimin e Kuranit përmendësh. Me iniciativën e profesorit hafëz. Shafi Osmani, në vitin 2014, nxënësi Evzal Sinani krahas mësimëve shkollorë mbaroi edhe hifzin me sukses. Më vonë vazhdoi kjo traditë e mirë me nxjerrjen e hafëzëve Ferat Plakaj (viti 2015), Isni Sinani dhe Ajdën Jahja (viti 2016), Orhan Zendeli (viti 2017) dhe Ariton Zeqiri, Jeton Hajdini dhe Orhan Ismaili (viti 2018).

Përfundimi dhe rekomandimet

Si përfundim me qëllim ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e institucionit të hifzit në trojet tona, mendojmë se do të ishte e udhës të japim rekomandimet e mëposhtme:

Përdorimi i teknologjisë për avancimin e hifzit, si interneti, CD etj.

Zhvillimi i një mini Erasmusi (këmbim të hafëzëve dhe studentëve të tyre midis institucioneve të hifzit) me qëllim të shkëmbimit të përvojave.

Organizimi i garave rajonale, me qëllim të rritjes së shpirtit konkurrues midis hafëzëve nga vende të ndryshme.

Vizita të ndryshme me qëllim relaksimin e nxënësve, duke pasur parasysh barrën e tyre psikologjike.

Shtimi i numrit të qendrave të hifzit.

Dhënia rëndësi edhe leximit të bukur (si shembull i mirë mund të na shërbejnë rastet e institucioneve formale apo joformale të hifzit në qytetet e Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kumanovës).

Duhet dhënë rëndësi edhe gjetjes së modaliteteve për përforcimin e hifzit të hafëzëve edhe pas diplomimit të tyre.

Vazhdimësia e nxjerrjes së hafëzëve dhe hafëzeve edhe gjatë mësimit në arsimin e mesëm (si rasti i medresesë “Isa Beu”, Shkup).

Zhvillimi i modaliteteve akademike për njohjen e hifzit të hafëzëve si kredi akademike nga ana e fakulteteve të shkencave islame në rajon.

Bibliografia

1. Bozkurt, N. (1989). “Hafız” Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi. Ankara: TDV Yayınları.
2. El Kettani, A. (1993). Et-Teratibul-idarijje: Hz. Peygamber’in Yönetiminde Sosyal Hayat ve Kurumlar (përkth: Ahmet Özel) I-III. Stamboll.
3. El Xhezari, E. (1982). Gajetun-Nihaje fi t̄abaqatil-ḳurra. Bejrut: G. Bergstraesser.
4. Ez Zehebi, M. (1995). Marifetul-kurrail-kibar aleṯ-t̄abaqat vel-ashar I-IV. Stamboll: Tayyar Altıkulaç.
5. Fazlić, S. (1981). Hafizi u Sarajevu. Sarajevo.
6. Hasandedić, H. (1977). Hafizi Mostara i okoline. Sarajevo: Takvim.
7. Huzai, A. (1981), Kitabu Taḫrihid-delalatis- semijje ala ma kane

- fi ahdi Resulillah minel ĥiref vesh-shanai vel-‘amalatish-sherijje.
Kairo: Ahmed M. Ebu Selame.
8. Ibn Haldun, (1983). Mukaddime II (përkth: Süleyman Uludağ). Stamboll.
 9. Ibn Hallikan, M. (1978). Vefeyatul-ajan ve enbau ebnaiz-zaman I-VIII. Bejrut: İhsan Abbas.
 10. Ibnul-Arabi, E. (1974). Aĥkamul-Ķur’an I-IV. Kairo: Ali M. el-Bixhavi.
 11. Kur’ani Famëlartë
 12. Mehdiu, F. (2010). Hafizët tanë gjatë historisë. Prishtinë: Shoqata e orientalistëve të Kosovës.
 13. Musnedi i Imam Ahmed bin Hanbelit.
 14. Sahihu i Buhariut.
 15. Sahihu i Muslimit.
 16. Suneni i Ebu Davudit.
 17. Suneni i Tirmidhiut.
 18. Suneni i Ibn Maxhes.
 19. Suneni i Darimiut.